



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**VENDIM**  
**Nr. 377, datë 22/10/2015**

**“Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës në rastet e dhënies së të drejtave ekskluzive ose të veçanta nëpërmjet kontratave koncesionare”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.10.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi procedurës së miratimit të kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”

**Baza ligjore:** Ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), neni 69 dhe neni 70, pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës** pas vlerësimit të Ligjit nr. 104/2015 “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)” nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

1. Sipas nenin 2, pika 1 germa c të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) (këtu e në vijim-“Ligji”), ky ligj zbatohet “për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta”.
2. Në nenin 69 pika 1 të Ligjit parashikohet: “detyrimi për organet qendrore dhe vendore që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt që ka të bëjë ndër të tjera me (b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara”.

3. Komisioni i Ekonomise dhe i Financave, në rezultatat e vlerësimit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zbatimin e detyrimit ligjor nga ana e institucioneve publike për marrjen e vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës si një instrument i domosdoshëm për rritjen e efciences se përdorimit të pasurisë publike. Më konkretisht Rezoluta për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014, cilëson: *“Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës: -Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit të akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizimeve sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.”*
4. Procedura për dhënien e konçensionit të formës “BOT” (ndërtim,shfrytëzim dhe transferim) në pronësi të shtetit (Built-Operate-Transfer/ BOT) të një Porti të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto-Romano, Durrës, është në shkelje të nenit 2, pika 1 (germa c) dhe atij 69, pika 1(germa b) të Ligjit, pasi nuk është zbatuar detyrimi ligjor nga Ministria e Transportit dhe Këshilli i Ministrave për të dërguar dhe marrë vlerësimin e Autoritetit Konkurrencës mbi këtë projekt-akt që vendos të drejta ekskluzive dhe/ose të veçanta, në një zonë të caktuar, për ndërmarrjen të cilës i është dhënë ky konçension.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

### **VENDOSI:**

1. T’i kërkojë Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë së Trajtimit të Konçensioneve që:
  - Të zbatojë nenin 2 pika 1 germa c dhe nenin 69 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Servete GRUDA</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Eduard YPI</b>
( _____ )	( _____ )	( _____ )	( _____ )
<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**